



Prishtinë, 27.01.2023  
Kodi i ZRRE-së: V\_1672\_2023

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2374\_10\_22** i dt.31.10.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 21.11.2022.

në seancën e mbajtur më datë **27.01.2023** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit J.B nga Komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2374\_10\_22 i dt.31.10.2022.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 31.10.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2374\_10\_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.09.2022 lidhur me kontestimin e faturës nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 dhe korrigjimit nr. 100559DPR-90167690 datë 05.09.2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë me njehsorin elektrik nr.20058382.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala J.B, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se fatura nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 nuk mund të jetë reale;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë si dhe të mundësoj kohëzgjatje me te madhe te pagesës.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 real me njehsorin elektrik nr.20058382 nuk është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si:



Shkresat dhe kërkesat e konsumatorit për lidhje të re dërguar KESCO datë 22.09.2020, 09.10.2020, 18.11.2020, 28.10.2020 dhe 24.08.2021, Procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik nr. 0131998 datë 24.05.2022; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0007377 datë 24.05.2022; Fatura nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022, Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 01.08.2022; Përgjigja e KESCO-s datë datës 12.09.2022; nr. 100559DPR-90167690 datë 05.09.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 23.09.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2374\_10\_22 i dt.31.10.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi gjeti se faturimi i kWh në faturën nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 nuk është real pasi që kjo është si rrjedhojë e kWh të grumbulluar për shkak të mos përgjigja nga ana KEDS konsumatorit në kërkesat për lidhje të re dhe se korrigjimi nr. 100559DPR-90167690 datë 05.09.2022 në vlerë **-2,938.24€** është real, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim të sipër të rastit, ZRRE ka vërejtur se, konsumatori me datë 22.09.2020, 09.10.2020, 18.11.2020, 28.10.2020 dhe 24.08.2021 bazuar në rregullat dhe procedurat në fuqi ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO/KEDS për lidhje të re, por që ekipet e KEDS vetëm me datë 24.05.2022, përkatësisht punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë bërë pranimin e instalimit elektrik për njehsorin elektrik nr. 20058382 me gjendje TL=040220 kWh dhe TU=028415 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se njehsori elektrik është i vendosur nga konsumatori, nuk ka llogo të KEDS andaj edhe behet ndërrimi i njehsorit dhe montohet njehsori nr. 58117120. Te njëjtën ditë punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 20058382 me gjendje TL=040220 kWh dhe TU=028415 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 58117120 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që ndërrimi i njehsorit behet sipas kërkesës së KEDS, pasi që njehsori nuk ka pasur llogo të KEDS, dhe dërgohet në qendrën e kalibrimit. Bordi i ZRRE bazuar në të dhënat e evidentuar në procesverbal si dhe kërkesës së konsumatorit për lidhje të re konstaton se KEDS me një vonesë 20 mujore ka inspektuar piken matëse të konsumatorit sipas kërkesës së tij për lidhje të re dhe se kWh e regjistruar në njehsorin nr. 20058382 vërtetojnë se ky njehsorë ka qenë i vendosur para se të behet pranimi teknik i instalimit të njehsorit elektrik nr. 20058382. Bordi i ZRRE konstaton se mos përgjigja nga ana KEDS konsumatorit në kërkesat për lidhje të re është në kundërshtim me Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me Energji përkatësisht nenit 3 paragrafit 3.2 e ku thuhet se: **“Operatori i Sistemit duhet të përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh ndaj çdo aplikimi për kyçje që është dorëzuar nga aplikuesit për kyçje në sistem”**.

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar faturën nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 dhe konstaton se kjo faturë paraqet kWh të grumbulluar dhe se në asnjë rast nuk mund të paraqet shpenzim real mujor të konsumatorit. Departamenti i faturimit në KESCO me datë 05.09.2022 përmes korrigjimit nr. 100559DPR-90167690 ka bërë korrigjimin në vlerë **-2,938.24 €** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën katër mujore, periudhën 02/2022 deri në periudhën 05/2022 për shkak të faturimit jo të saktë. ZRRE duke marrë për bazë edhe kërkesën për lidhje të re 22.09.2020 si dhe shpenzimet e konsumatorit ka bërë shpërndarjen e këtyre kWh për periudhën 09/2020 deri në periudhën 05/2022 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar. Po ashtu sipas korrigjimit të bërë nga Departamenti i faturimit vërtetohet se kWh e regjistruar në listën e leximit të datës 21.01.2022 nuk janë faturuar me strukturën e re tarifore por vetëm diferenca e kWh pas regjistrimit të njehsorit nr. 20058382 (TL=7,377 kWh dhe TU=7,479 kWh). ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, shkresat dhe kërkesat e konsumatorit për lidhje të re të dërguar KESCO/KEDS datë 22.09.2020, 09.10.2020, 18.11.2020, 28.10.2020 dhe 24.08.2021, rrjedhën e energjisë elektrik, listat e leximit, procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik nr. 0131998 datë 24.05.2022, procesverbalin e mbi ndërrimit dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0007377 datë 24.05.2022, korrigjimin nr. 0622285785DPR-90167690 datë 21.06.2022 si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar



**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit J.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.